



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

A.A.nr.1/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj V. A., prokuror në Prokurorinë Themelore në F., kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së prokurorit V. A. , paraqitur kundër Vendimit KPK/Nr. ..., datë 12 janar 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16 shkurt 2022 merr këtë:

### A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së prokurorit V. A., prokuror në Prokurorinë Themelore në F. priset vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës nr. KPK. Nr.... të datës 12.1.2022 dhe lënda kthehet në rishqyrtim Këshillit Prokurorial të Kosovës .

### A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr...., datë 12 janar 2022, në pikën I, aprovohet si i bazuar Raporti i Panelit hetimor, AD nr.... i datës 30 dhjetor 2021, në rastin disiplinor kundër prokurorit V. A., prokuror në Prokurorinë Themelore në F.. Në pikën II të vendimit vërtetohet se, prokurori është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 6, paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën III të dispozitivit, prokurorit V.A., i shqiptohet masa disiplinore transferimi i përhershëm në Prokurorinë Themelore në Gj., në Departamentin e përgjithshëm ‘’, sipas nenit 7 , paragrafi 1,

pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij Vendimi, prokurori V. A., në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të aplikimit të gabuar të drejtës materiale , shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj dhe gabimeve faktike që kanë ndikuar në procedurë dhe vendimmarrje lidhur me masën disiplinore, me propozim që Gjykata Supreme ta aprovoi ankesën dhe të ndryshoj vendimi e goditur duke liruar nga përgjegjësia disiplinore parashtruesin e ankesës ose të anulojë vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në përgjigje ndaj ankesës së prokurorit pretendon se ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë edhe për faktin se në veprimet e prokurorit V. A. ka elemente të veprës disiplinore nga neni 6,pragarfi 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se sanksioni disiplinor ndaj prokurorit është adekuat, në përputhje me të gjeturat e panelit hetimor dhe do të ketë efekt pozitiv në punën e prokurorit në të ardhmen.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të vendimit të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësin disiplinore të gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji numër 06/L-057) ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Në shkresat e lëndës del se më datën 28 tetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pranuar nga Autoritetit Kompetent propozimin për fillimin e procedurës hetimore ndaj V. A., prokuror në Prokurorinë Themelore në F., me propozim që të njëjtit t'i shqiptohet masa disiplinore zvogëlimi i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri 1(një ) vit. Me 2 nëntor 2021,Këshilli Prokurorial i Kosovës , ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rastit disiplinor , ndaj prokurorit V. A. prokuror në Prokurorinë Themelore në F..

Më 30 dhjetor 2021, Paneli Hetimor i ka dorëzuar raportin Këshillit Prokurorial të Kosovës me përfundim se Prokurori V. A., ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2.1 pika 2.10. Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror sepse në rastin e parë, AD.nr. 06/2019, ka vepruar

në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ashtu që në lëndën penale, PP.I.nr....,që ka të bëjë me ndodhjen e aksidentit të komunikacionit mes dy automjeteve të përfshira ku si pasojë pesë persona kanë gjetur vdekjen në mesin e tyre një i mitur , ndërsa prokurori V. A. e zëvendëson masën e paraburgimit në arrest shtëpiak dhe ka ngritur aktakuzë pa kryer hetimet .

Në kësi rrethanash KPK-ja pasi shqyrtoi provat dhe dëgjoji palët, në seancën e datës 12 janar 2022 vendosi si në dispozitivin e vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme ka gjetur se ka një paqartësi në vendimin e Këshillit Prokurorial , për shkak se në pikën e I (parë) të dispozitivit, ka aprovuar raportin e panelit hetimor, e që në raportin e panelit hetimor theksohet se prokurori V. A. ka bërë shkelje të nenit 6 par.2 nën paragrafi 2.10 ,të 1 Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, sepse i njëjti me paraqitjen e kërkesës për zëvendësimin e masës së paraburgimit në arrest shtëpiak, akoma pa i siguruar të gjitha provat materiale , ka dëmtuar besimin e publikut në paanshmëri ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit .Këshilli Prokurial i Kosovës, ka aprovuar raportin Panelit Hetimor , ndërsa në dispozitiv të vendimit të saj ka vërtetuar një shkelje e cila nuk është cekur në raportin e Panelit Hetimor të datës 30 dhjetor 2021

Në vendimin e atakuar është konstatuar se prokurori V. A. ka bërë shkelje nga neni 6 paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e cila përfshin veprimet e prokurorit *‘se në mënyrë të vazhdueshme nuk ndërmerr ndonjë veprim prokurorial që kërkohet me ligjin në fuqi ose nuk ushtron funksionet prokuroriale brenda afateve kohore të parapara me ligj , përveç nëse serioziteti i mosveprimit apo niveli i shkeljës paraqet bazë për incimin e procedurës disiplinore për një shkelje të vetme’’* Prandaj shkelja e përshkruar si në dispozitiv të vendimit të ankimuar nuk përkon me përshkrimin që është bërë nga paneli hetimor ,dhe bën të paqart dispozitivin dhe arsyetimin e vendimit të atakuar. Prandaj edhe pretendimet e parashtruesit të ankesë se kjo mungesë dhe paqartësi , bie ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës si dhe neni 6 të Konventës Evropiane të për të Drejta e Njeriut, janë bazuara .

Në rishqyrtim Këshilli Prokurorial i Kosovës Gjyqësor të Kosovës duhet të veproj në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe

Prokurorëve të eliminoj këtë paqartësi dhe kontradiktoritet të vendimit të atakuar dhe të vërtetoj shkeljen e bërë nga Prokurori V. A. dhe për shkelje disiplinore nga prokurori, të shqipton masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë parasysh numrin dhe seriozitetin, pasojat, dhe rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore.

Për sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi e në bazë të nenit 15 pika 6 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligji nr.06/L-057.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËSË- PRISHTINË  
A.A.nr.1/2022 datë 16 shkurt 2022

Kryetar i kolegjit  
Erdogan Haxhibeqiri